



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1576/3 prot.

Tiranë, më 30.10.2025

VENDIM

Nr. 37, datë 30.10.2025

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularin e ankesës me nr. 1576 prot., datë 11.06.2025, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, me anë të kërkesës për informacion, datës 14.05.2025, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, mbi Programin për Tiranën si Kryeqytet Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025, i titulluar “*Urat MESDHETARE*” në lidhje me:

1. Në kuadër të Programin për Tiranën si Kryeqytet Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025, i titulluar “*Urat MESDHETARE*”, sa aplikime ka pasur nga subjekte të interesuar për të zbatuar projektet (nga 1 janari 2025 dhe deri në ditën që do jepni informacionin)?
2. Sa aplikime ka miratuar deri në ditën që do të jepni informacionin Këshilli Artistiko-Kulturor në Bashki, në kuadër të Programit për Tiranën si Kryeqytet Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025, i titulluar “*Urat MESDHETARE*”, sa aplikime ka miratuar deri në ditën që do të jepni informacionin?
3. Cilat kanë qenë subjektet konkrete (ojf, individë a institucione), që Këshilli Artistiko-Kulturor në Bashki ia ka miratuar projektet për t’u zbatuar? Çfarë vlere financiare ka kërkuar nga Bashkia secili prej këtyre subjekteve për zbatimin e projektit?

4. *Çfarë vlere konkrete financiare ka miratuar Bashkia për secilin nga subjektet që do mbështeten nga Bashkia për zbatimin e projekteve të tyre?*
5. *Çfarë buxheti financiar ka miratuar Bashkia e Tiranës për vitin 2025 për të mbështetur Programin për Tiranën si Kryeqytet Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025, i titulluar “Urat MESDHETARE”? (Kemi interes të kemi kopje të dokumentit të vendimmarrjes së institucionit mbi këtë aspekt).*

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it, datë 03.06.2025, ka bërë me dije kërkuesin se kërkesa për informacion është protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. prot. J-10684, datë 14.05.2025 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit me shkresën nr. prot. J-10684/1, datë 23.05.2025 ju ka kthyer përgjigje.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me pretendimin se *përgjigja e kthyer nuk ka asnjë lidhje me kërkesën për informacion*, nëpërmjet e-mail-it datë 03.06.2025, i është drejtuar Autoritetit Publik duke i kërkuar vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar, në respektim të ligjit për të drejtën e informimit.

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisioneri, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga Autoriteti Publik.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 1576/1 prot., datë 12.06.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, brenda datës 19.06.2025.

Autoriteti Publik në vijim të trajtimit të ankesës me e-mail-in datë 21.08.2025 i ka kthyer ankuesit përgjigje, duke e informuar se: “*Për periudhën kohore Janar – Korrik 2025, Këshilli Artistiko – Kulturor ka dhënë mbështetjen për 132 projekte artistike dhe kulturore, bazuar në prioritetet dhe objektivat për vitin 2025 si “Tirana - Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut”.*

Numri total i projekteve të aplikuara për periudhën Janar - Korrik ka qenë 254 aplikime, të ardhura nga individë ose subjekte të ndryshme.

Për vitin 2025, periudha Janar – Korrik janë realizuar 7 mbledhje të Këshillit Artistiko – Kulturor. Në këtë periudhë, nga buxheti i Drejtorisë së Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore është shpenzuar 51.8% e buxhetit të drejtorisë.

48.2% e buxhetit është në dispozicion të projekteve për projekt propozimet që do të shqyrtohen në mbledhjet e ardhshme të Këshillit Artistiko – Kulturor për periudhën Shtator – Dhjetor 2025”.

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me e-mail-in datë 21.08.2025, pretendon se përgjigja e kthyer nga Autoriteti Publik nuk është e plotë, pasi i është kthyer përgjigje për pikën e parë dhe të dytë të kërkesës. Në këto kushte, ka vijuar ankimin duke i kërkuar Zyrës së Komisionerit përmbushjen e detyrimit për dhënien e plotë të informacionit të kërkuar nga Autoriteti Publik, konkretisht për pikat 3, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës për informacion lidhet me përfitime të fondeve publike në kuadër të politikave dhe veprimtarisë së Autoritetit Publik, që Organizata Jofitimprurëse, individividë kanë përfituar nga Autoriteti Publik, nëpërmjet thirrjeve publike.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.* Në kuptim të këtij parashikimi, Bashkia Tiranë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë është vetë ky autoritet që detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Konstatohet se, Autoriteti Publik në kthim përgjigjen me e-mail-in e datës 21.08.2025, nuk ka argumentuar mosvënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar të bazuar në rastet e parashikuara për kufizim që neni 17 i LDI parashikon. Pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Bazuar në ligjin nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, konkretisht në nenin 38, “Publikimi elektronik” parashikohet se: *“1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë*

publikon në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, që mbahet nga sekretaria e regjistrit, në format elektronik dhe në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çdo rast të regjistrimit ose të ndryshimit të të dhënave në regjistër të dhënat e mëposhtme: a) emrin; b) formën e organizimit; c) datën e themelimit; ç) qëllimin dhe fushën e veprimtarisë; d) kohëzgjatjen, në qoftë se është e përcaktuar; dh) emrin e përfaqësuesit ligjor; e) numrin unik të identifikimit. 2. Sekretaria e regjistrit elektronik kryen publikimin në buletin brenda 1 (një) dite nga data e kryerjes së regjistrimit. Për çdo publikim përcaktohet qartë data në të cilën është regjistruar e dhëna e publikuar. 3 Publikimi në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit përbën publikim zyrtar të regjistrimeve, të kryera në kuptim të nenit 7 të këtij ligji. 4. Publikimi i të dhënave sipas këtij neni kryhet në përputhje me kufizimet e vendosura nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Legjislacioni i sipërcituar përjashton qartazi organizatat nga parashikimet e pikës 1 të nenit 17 të LDI, “1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm a) të drejtën për një jetë private, b) sekretin tregtar, c) të drejtën e autorit dhe ç) patentat”. Në zbatim të këtij parashikimi, Autoriteti Publik nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë se cila nga pikat e mësipërme cenohet, duke u publikuar emri i organizatës, e cila ka përfituar/fituar thirrjen. Në çdo rast, duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me përfitime nga buxheti i shtetit, interesi publik për të aksesuar informacionin/dokumentacionin e kërkuar, në këtë rast është i drejtpërdrejtë dhe tejet i lartë.

Në këtë analizë, Komisioneri vlerëson se, bazuar në pikën 6 të nenin 17 të LDI, sipas të cilit parashikohet se: “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”, Autoriteti Publik, duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të dokumentacionit të kërkuar, të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të informacionit.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilës: “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: “Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.

Gjithashtu, detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njërive të qeverisjes vendore i'u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Konkretisht në nenin 15 të ligjit të sipërcituar “Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore”, parashikohet se: *“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...”*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Në këtë kontekst, në lidhje me të njëjtën objekt kërkesë për informacion, Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, me nr. 1576 prot., datë 11.06.2025, ndaj Autoritetit Publik, Bashkia Tiranë me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 14.05.2025, konkretisht: *“ 1. Cilat kanë qenë subjektet konkrete (ofj, individë a institucione), që Këshilli Artistiko-Kulturor në Bashki ia ka miratuar projektet për t’u zbatuar? Çfarë vlere financiare ka kërkuar nga Bashkia secili prej këtyre subjekteve për zbatimin e projektit? 2. Çfarë vlere konkrete financiare ka miratuar Bashkia për secilin nga subjektet që do*

mbështeten nga Bashkia për zbatimin e projekteve të tyre? 3. Çfarë buxheti financiar ka miratuar Bashkia e Tiranës për vitin 2025 për të mbështetur Programin për Tiranën si Kryeqytet Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025, i titulluar “Urat MESDHETARE”? (Kemi interes të kemi kopje të dokumentit të vendimmarrjes së institucionit mbi këtë aspekt).”, brenda datës 06.11.2025.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 30.10.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi